

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zbeli, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Jeton Leci, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.I. nga Gjilani, rruga “..”, për shkak të dy veprave penale, sulm nga neni 187 par. 3 lidhur me par. 1, dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.835/2018 të datës 01.10.2018, të mbajtur me datë 19.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.835/2018 të datës 01.10.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.835/2018 të datës 01.10.2018, të akuzuarin E.I., e ka shpallur fajtor për shkak të dy veprave penale, sulm nga neni 187 par. 3 lidhur me par. 1, dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së. Gjykata e shkallës së parë të akuzuarin e ka gjykuar për secilën vepër veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 5 (pesë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa konform nenit 80 par.2 pika 2.3 të KPRK-së, të njëjtit i është shqiptuar dënimi unik me burgim me kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale. Në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim edhe atë nga data 06.09.2018 e deri më 01.10.2018, do të llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, I akuzuari është obliguar që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjiilan, dhe atë vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta aprovoj ankesën në tërësi si të bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar me ankesë ta ndryshojë dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim me burgim efektiv.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.1274/2018 datë 14.10.2018, ka propozuar që ankesa e prokurorit të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj te akuzuarit të shqiptohet një dënim me burg efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimin të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, me ankesë prokurori pretendon se Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënimin e merituar në pajtim me ligjin, sepse dënimi i shqiptuar është në kundërshtim me rregullat e përgjithshme mbi matjen dhe caktimin e drejtë të dënimit të përcaktuar me nenin 73, pastaj ato të zbutjes së dënimit dhe kufijtë e kësaj zbutje të përcaktuara me nenet, 74,75,dhe 76 të KPRK-së. Sipas ankesës së prokurorit, rrethanat lehtësuese nuk kanë mundur të vlerësohet në këtë masë duke ndikuar që dënimi të zbutet, kurse rrethanave rënduese nuk u ka dhënë peshë të njëjtë. Me ankesë, prokurori pretendon se gjykata nuk e ka marr parasysh faktin se kemi të bëjmë me vepra penale të kryera në drejtim të dëmtimit të integritetit trupor, përkatësisht sulmit fizik, faktin se vepra penale është kryer brenda familjes, në prani të fëmijëve, jo vetëm që e ka dëmtuar të dëmtuarën duke e sulmuar fizikisht, duke e fyer, frikësuar e përlurur, por kjo ka ndikuar rëndë edhe në psikologjinë e fëmijëve, por gjykata këto nuk i ka marrë parasysh dhe të akuzuarit i ka shqiptuar minimumin e dënimit të parashikuar

ligjor, dënim që bie në kundërshtim me qëllimin e dënimit, pasi për të arritur qëllimin ndaj kryerësve të veprës penale, duhet ti kemi parasyshë rrethanat e parapara në nenin 41 të KPRK-së, që vlerëson se në rastin konkret një dënim me burg në pajtim me dispozitat ligjore do të ndikonte në përgjegjësin e tij në të ardhmen që mos të bëj veprime të tilla në kundërshtim me ligjin dhe do të ishte një shembull për qytetarët. Prokurori me ankesën e tij pretendon se me një dënim të tillë nuk do të parandalohet kryerja e veprave penale dhe nuk do të arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksionit penal, andaj e vlerëson dënimin e shqiptuar si jo adekuat për veprën penale dhe i propozon gjyktës së Apelit që aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj dhe të akuzuarit ti shqiptoj një dënim me burg efektiv.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e Prokurorit për shqiptimin e një dënimi me burg efektiv për të akuzuarin, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73,74,75 dhe 76 të KPK-së, me ç ‘rast si rrethanë posaçërisht lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar pranimin e fajësisë, se i njëjti është penduar dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale si dhe raportet familjare mes tyre, duke marrë parasysh faktin se të dëmtuarit gjegjësisht F.Z. bashkëjeton me të njëjtin, është baba i katër fëmijëve dhe në mesin e fëmijëve janë edhe të dëmtuarit V. dhe R.I. , ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori për bazë shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Pretendimet e Prokurorit që ta dënoj të akuzuarin me dënim me burg efektiv, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, ngase duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, si dhe faktin që bazuar në shkresa të lëndës, tani e dëmtuara ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit sepse i njëjti është i dhunshëm vetëm kur është i dehur ndërsa djemtë e të akuzuarit kanë deklaruar se janë të gatshëm që prindit të tyre t’ia japin edhe një shanse, del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e me qenë se në ankesën e Prokurorit, nuk theksohet ndonjë rrethanë e re rënduese, e që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe që do të ndikonte në shqiptimin e ndonjë dënimi tjetër, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutorë dhe se ky dënim do t’i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tyre, dhe do të ndikoj në përmbajtjen e

peronave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1271/18 me datë 19.12.2018

Bashkëpunëtori profesional
Jeton Leci

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

Shqipe Qerimi
Afrim Shala